



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	14.10.2025
REFERENC-Ë:	642-25-6973-5-2-1
PËR/ZA/TO:	Operatori Ekonomik: "VALDRINI" SH.P.K.
NGA/OD/FROM:	Zyra e Prokurimit - Kushtrim Mehaj – Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim për Aktivitetin e Prokurimit: "Ndërtimi i rrugës Vllahi-Zhazhë", me nr. të prok: 642-25-6973-5-2-1

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Mitrovicës Jugore në mbështetje të nenit 108/A, (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Operatori Ekonomik: "VALDRINI" SH.P.K., të datës **13.10.2025** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugës Vllahi-Zhazhë", me nr. të prok: 642-25-6973-5-2-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës **07.10.2025**, Autoriteti Kontraktues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar me datë 13.10.2025, nga Operatori Ekonomik: "VALDRINI" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i rrugës Vllahi-Zhazhë", me nr. të prok: 642-25-6973-5-2-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës **13.10.2025**.
2. Autoriteti Kontraktues qëndron prapa Njoftimit për kontratë për Aktivitetin e Prokurimit dhe sipas LPP-ës dhe legjislacionit dytësor të Prokurimit Publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M M B I R E F U Z I M I N

Operatori Ekonomik: "VALDRINI" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i rrugës Vllahi-Zhazhë", me nr. të prok: 642-25-6973-5-2-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës 07.10.2025, ka bërë Kërkesës për Rishqyrtim me datë **13.10.2025** sipas nenit 108/A, të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L/237. Pas analizimit të pretendimeve ankimore AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar për këto arsye:

PRETENDIMI ANKIMOR 1):

PRETENDIMET TONA PËR GOE të propozuar për fitues Eurondertimi Sh.p.k & Kab Holding Sh.p.k JANË :

PRETENDIMI I PARË : Sipas rregullores së ATK-se , Vertetimi tatimor ka validitet 90 dite nga data e lëshimit , Ndërsa AK Shpallë fitues GOE Eurondertimi Sh.p.k & Kab Holding Sh.p.k , ku antari i konzierciimit Kab Holding shpk ka ofruar Vertetimin tatimor me afat të skaduar , sepse vertetimi tatimor i tij është lëshuar me datë : 14.06.2025 i cili ka validitet 90dite deri me date : 11.09.2025 ndërsa Goe është shpallur fitues me date : 07.10.2025.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 1 ANKIMORE NDAJ OE “VALDRINI” SH.P.K.:

Autoriteti Kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit për Kontratë me datë 08.08.2025 ndërsa dokumenti apo Vërtetimi Tatimor i anëtarit të konzerciumit OE KAB Holding SH.P.K. ka prezentuar me ofertën e tij **14.06.2025** gjithashtu dhe Marrëveshjen për pagesë të borxheve me këste e cila duhet të jetë para datës së Njoftimit për Kontratë ku edhe këtë dokument e ka prezentuar. Dokumentet e tilla kërkohej para publikimit të Njoftimit për Kontratë **së paku deri në 3 (tre) mujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë nëse keni Marrëveshje për shlyrje të borxhit me ATK-në - Marrëveshja në fjalë duhet të jetë para publikimit të Njoftimit për Kontratë – Kopje.** Prandaj Vërtetimi është i lëshuar para datës së publikimit 14.06.2025 ndërsa publikimi është bërë 08.08.2025 dhe hapja është bërë 11.09.2025 gjithashtu dhe marrëveshja është para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar sipas LPP-sës dhe Legjislacionit Sekondar të Prokurimit Publik.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 2):

PRETENDIMI I DYTË : Në dosjen e tenderit të kapaciteti teknik dhe profesional kërkohej : Kërkesa 6. OE duhet të ketë min.10 punëtor-staf të angazhuar në këtë projekt , Dëshmia 6. Listën e punëtorëve dhe Kontratat kopje nga origjinali e nënshkruar nga të dy palët dhe e vulosur nga OE valide ose parakontrata në emër të projektit.

Sipas kësaj kerkese në Dt. Kërkohej që Kontratat me punëtorë të jenë të nënshkruara nga të dy palët dhe e vulosur nga OE , ndërsa Lideri i grupit Eurondertimi shpk ka ofruar 3 kontrata me punëtorë të cilat nuk janë të nënshkruara nga OE Eurondertimi shpk , konkretisht kontratat për punëtorët me mbiemra : Kadrija ,Xhafa,Istrefi.

GOE : Nuk ka plotësuar këto kriter sipas dt.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 2 ANKIMORE NDAJ OE “VALDRINI” SH.P.K.:

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar të gjitha kontratat e punës për punëtorët ku edhe lideri i grupit edhe anëtar i konzerciumit e tejkalojnë numrin minimal të punëtorëve të kërkuar sipas DT-së dhe NJK-së ku sipas kriterit nuk ka qenë e specifikuar se Lideri duhet të ketë së paku 51% apo diçka e tillë dhe anëtar i konzerciumit ka prezentuar me listë dhe kontrata të punës më shumë 20 punëtor.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 3):

PRETENDIMI I TRETË : Në dosjen e tenderit të kapaciteti teknik dhe profesional kërkohej : Kërkesa 2. Një (1) Menaxher i Projektit - Inxhinier ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit i licencuar nga OIRK , Dëshmia 2. Kopjen e Diplomës dhe Licencës, Kontrata kopje nga origjinali e nënshkruar nga të dy palët dhe e vulosur nga OE valide ose parakontrata në emër të projektit, duhet të bashkëngjitet CV ose referenca ose vërtetimet për dëshminë e përvojës së punës të prezentuar.Vendimi për Menaxher të Projektit e nënshkruar dhe vulosur nga Menaxheri dhe OE (Menaxheri nuk duhet të jetë i punësuar në ndonjë Institucion shtetëror apo privat me orar 8 orë të rregullt të punës pasi që duhet të jetë i angazhuar në këtë projekt).

-NDERSA GOE : Eurondertimi Sh.p.k & Kab Holding Sh.p.k, nuk e plotësojnë këto kriter sipas kërkesës se AK në dt. sepse nuk kanë ofruar për Menaxherin e projektit dëshmitë për përvojën e punës , Mungojnë : CV, Referenca ose vërtetimet për dëshmi të përvojës së punës .

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 3 ANKIMORE NDAJ OE “VALDRINI” SH.P.K.:

Komisioni i Vlerësimit i Autoritetit Kontraktues ka verifikuar të gjitha kërkesat ku sipas ofertës të prezentuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë i plotëson kriteret sipas DT-së dhe NJK-së ku Menaxheri i Kontratës ka prezentuar CV-në dhe Referenca për përvojën e punës. Gjithashtu edhe pas kërkesës për qasje ju kemi dorëzuar-prezentuar edhe CV-në dhe Referencat e punës për këtë Menaxher.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 4):

PRETENDIMI I KATËR : Në dosjen e tenderit te kapaciteti teknik dhe profesional kerkohet : **Kërkesa 3.** Një (1) Udhëheqës i Punishtës - Bachelor ose Master i Ndërtimtarisë min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit i licencuar nga OIRK , Dëshmia 3. Kopjen e Diplomës dhe Licenca, Kontrata kopje nga origjinali e nënshkruar nga të dy palët dhe e vulosur nga OE valide ose parakontrata në emër të projektit, duhet të bashkangjitet CV ose referenca ose vërtetimet për dëshminë e përvojës së punës të prezentuar. Vendimi për Udhëheqës të Punishtës e nënshkruar dhe vulosur nga Udhëheqësi i Punishtës dhe OE (Udhëheqësi i Punishtës nuk duhet të jetë i punësuar në ndonjë Institucion shtetëror apo privat me orar 8 orë të rregullt të punës pasi që duhet të jetë i angazhuar në këtë projekt).

-NDERSA GOE : Eurondertimi Sh.p.k & Kab Holding Sh.p.k, nuk e plotesojne kete kriter sipas kerkeses se AK ne dt. sepse nuk kane ofruar per Udhëheqesin e punishtes deshmite per përvojene punes ,

Mungojne : CV, Referenca ose vërtetimet per deshmë te përvojes se punes .

-Poashtu deshmite e përvojes se punes mungojne edhe per Inxhinierin e Hidros dhe per Gjeodetin.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 4 ANKIMORE NDAJ OE “VALDRINI” SH.P.K.:

Komisioni i Vlerësimit i Autoritetit Kontraktues ka verifikuar të gjitha kërkesat ku sipas ofertës të prezentuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë i plotëson kriteret sipas DT-së dhe NJK-së ku Udhëheqësin e Punishtës e ka prezentuar me CV dhe Referenca për përvojën e punës. Gjithashtu edhe pas kërkesës për qasje ju kemi dorëzuar-prezentuar edhe CV-të dhe Referencat e punës për Udhëheqësin e Punishtës, Inxhinierin e Hidros dhe për Gjeodetin.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 5):

PRETENDIMI I PESTË : Në dosjen e tenderit te kapaciteti teknik dhe profesional kerkohet : **Kërkesa 7.** Operatori Ekonomik duhet të ketë një Listë për pajisjet-mjetet stabilimentet që ka në dispozicion për realizimin e projektit sipas Aneksit 7 , Dëshmia 7. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera të cilat nuk regjistrohen, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Dëshmit per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listes se bashkangjitur ne Aneksin 7. Gjithashtu të ipen karakteristikat gjegjesisht specifikat teknike të veçanta per secilen nga pajisjet, kapacitetin e tyre dhe te dhenat e nevojshme per evidentimin sa me te sakt te pajisjeve sipas kerkeses, deshmët duhet te jene te dukshme.

- NDERSA GOE : Eurondertimi Sh.p.k & Kab Holding Sh.p.k, nuk e plotesojne kete kriter sipas kerkeses se AK ne dt. sepse nuk kane ofruar LISTEN E PAISJEVE , perkatesisht nuk kane plotesuar fare Aneksin 7. Goe nuk e ploteson fare kete kerkese te domosdoshme te dt. Dhe per kete duhet te eliminohet nga gara.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 5 ANKIMORE NDAJ OE “VALDRINI” SH.P.K.:

Ky pretendim nuk qëndron pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka prezentuar Listën e pajisjeve dhe pajisjet sipas kërkesës në DT dhe NJK, ku po ju prezentojm edhe njëherë:

Numri i Prokurimit: 642 25-6973-S-2-1 - Titulli "Ndërtimi i rrugës Vilah-Zhazhe"

Aneksi 7. LISTA E PAISJEVE

No.	Lloji i mekanizmit dhe pajisjeve	Sasia minimale e kerkuar (copa)	Sasia që ofron ofertuesi	Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit valide, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.
1				

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 6):

PRETENDIMI GJASHTË : GOE :Eurondertimi Sh.p.k & Kab Holding Sh.p.k, kanë ofruar dokumente perkatesisht kontrata me punetore dhe staf profesional , te cilat jane konfidenciale , dhe na eshte pamundesuar vlersimi i tyre se a i plotesojne kriteret e kerkuara ne dt apo jo.Mirepo ne kete gjendje ne mendojme se nuk plotesojne kriteret e kerkuara nga AK ne dt. Dhe njoftimin per kontrate.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 6 ANKIMORE NDAJ OE “VALDRINI” SH.P.K.:

Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik EURONDERTIMI SH.P.K.; Kab Holding SH.P.K. i cili ka prezentuar stafin profesional sipas kushteve dhe kriterëve të vendosura nga Autoriteti Kontraktues, gjithashtu ju njoftojmë se pas kërkesës për qasje në dokumente AK ju ka prezentuar dokumentet e pastruara-markuara pasi që kërkesa për sekret afarist është e plotësuar nënshkruar dhe vulosur nga GOE që dokumentet të cilat konsiderohen si ruajtje e konfidencialitetit-informacionit dhe ruajtje e besimit midis punëdhënësit dhe punëmarrësit të mbrohen duke i markuar në mënyrë që mos të dëmtohet integriteti i punonjësve në fjalë.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 7):

PRETENDIMI I SHTATË : GOE :Eurondertimi Sh.p.k & Kab Holding Sh.p.k, kanë ofruar dokumente perkatesisht deshmi te paisjeve te cilat jane konfidenciale (jane mbuluar te dhenat e nevojshme) dhe na eshte pamundesuar vlersimi i tyre se a i plotesojne kriteret e kerkuara ne dt apo jo. Mirepo ne kete gjendje ne mendojme se nuk plotesojne kriteret e kerkuara nga AK ne dt. Dhe njoftimin per kontrate.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 7 ANKIMORE NDAJ OE “VALDRINI” SH.P.K.:

Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik EURONDERTIMI SH.P.K.; Kab Holding SH.P.K. i cili ka prezentuar listën e paisjeve sipas kushteve dhe kriterëve të vendosura nga Autoriteti Kontraktues, gjithashtu ju njoftojmë se pas kërkesës për qasje në dokumente AK ju ka prezentuar dokumentet e pastruara-markuara pasi që kërkesa për sekret afarist është e plotësuar nënshkruar dhe vulosur nga GOE ku është specifikuar shumë qartë se Konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave të makinerive në rast të zbulimit të informatave do t'i shkaktojë dëm material biznesit dhe mund të dëmtojë avantazhin konkurrues të kompanisë në aktivitetet të ndryshme. Prandaj, AK duke e analizuar këtë kërkesë për sekret afarist e ka pa të arsyeshme që ti markojë-pastrojë informacionet e makinerive dhe ju ka prezentuar dokumentet në fjalë. AK ka vepruar sipas nenit 7 të Rregullorës Nr.002/2024.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 8):

PRETENDIMI I TETË : AK ka bërë shkelje duke dëmtuar buxhetin komunal në vlerë : 13,778.40 € , duke rekomanduar për kontratë GOE Eurondertimi Sh.p.k & Kab Holding Sh.p.k , te cilet jane te papergjegjshem dhe kane ofruar qmimin me te larte ne mesin e ofertueseve , duke na tejkaluar NE si OE : Valdrini shpk te pergjegjshem me qmimin me te lire te ofruar .

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 8 ANKIMORE NDAJ OE “VALDRINI” SH.P.K.:

Nuk qëndron pretendimi se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje dhe ka dëmtuar buxhetin komunal në vlerë prej 13,778.40 €, pasi procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Rekomandimi për kontratë është bërë mbi bazën e vlerësimit teknik dhe ekonomik të ofertave të pranuar, duke respektuar kriterin e përcaktuar në dosjen e tenderit. Oferta e rekomanduar ka përmbushur të gjitha kërkesat teknike dhe administrative.

Po ashtu ju njoftojm se vlera e ofertës më të ulët nuk mund të konsiderohet automatikisht si ofertë fituese, nëse ajo nuk përmbush kushtet ligjore dhe teknike të dosjes së tenderit. Prandaj, Autoriteti Kontraktues ka vepruar drejt dhe në përputhje me ligjin, pa shkaktuar asnjë dëm në buxhetin komunal.

Ndërsa sa i përket pretendimeve tuaja se ju i plotësoni kriteret dhe kushtet sipas DT-së dhe NJK-së sipas kërkesës suaj:

1.Sipas kërkeses se AK, Makine per hapje te kanaleve ne toke me zingjire min.12 ton ,kjo eshte nje makine perkatesisht eskavator e cila sherben per hapje te kanaleve , dhe ne kemi ofruar nje Makine (eskavator) me zingjir dhe luge ,Komatsu, PC290 , pesha 29.25 ton , i cili sherben per hapje te kanaleve dhe si i tille eshte i njejte me kete kerkese dhe e kryen funksionin e njejte. Edhe ne dudin doganor te tij shenon Makinerite me rrotullim te superstruktures (eskavator me zingjir dhe luge i cili sherben per hapje te kanaleve , germime etj). Qdo makine e llojit eskavator apo bager e kryen funksinin per hapje te kanaleve ne toke, dhe nese Ak ka pasur dilema per kete ka mundur te kerkoj sqarime dhe kjo arsye e AK per eliminimin tone eshte jo profesionale, tendencioze dhe e pa qendrueshme.

2.Sipas kërkeses se AK, Frezë per grryerjen e asfaltit dhe perpunimin e asfaltit min.15 ton , ne kemi ofruar Freze per grryerje te asfaltit dhe perpunimin e asfaltit , MP 1000,SN 1006 , pesha : 16.80 ton e cila e kryen po te njehtin funksion per grryerje dhe perpunim sipas kërkeses se AK , sepse te gjitha frezat qe sherbejne per grryerje te asfaltit njekohesisht bejne perpunimin e tij , edhe pse per natyren e puneve qe do te kryhen ne kete projekt ne paramase dhe parallogari nuk kerkohet askund gerryerje apo perpunim i asfaltit , megjitheate ne kemi plotesuar kete kerkese te AK , dhe nese Ak ka pasur dilema per kete ka mundur te kerkoj sqarime , por kjo arsye e AK per eliminimin tone eshte jo profesionale, tendencioze dhe e pa qendrueshme.

Lidhur me eliminimin e ofertës suaj, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe pajisjeve të ofruara, Autoriteti Kontraktues sqaron si më poshtë:

Lidhur me mjetin për hapje të kanaleve në tokë me zinxhirë (eskavatorin) të prezentuar nga ana e juaj. Sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit, është kërkuar “Makinë për hapje të kanaleve në tokë me zinxhirë me peshë minimale 12 ton”, e cila duhet të shërbejë specifikisht për funksionin e hapjes së kanaleve.

Pas verifikimit të dokumentacionit teknik të ofruar nga Operatori Ekonomik “Valdrini” SH.P.K., u konstatua se mjeti i paraqitur nuk përputhet plotësisht me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kjo mospërputhje përbën arsye të mjaftueshme për skualifikim, pasi specifikimet teknike janë element detyrues dhe të pandryshueshëm në procesin e vlerësimit të ofertave.

Lidhur me frezën për gërryerjen e asfaltit dhe **përpunimin e asfaltit**. Edhe pse pajisja e ofruar kryen funksione të ngjashme me ato të kërkuara, dokumentacioni i dorëzuar nuk provon përputhshmërinë e plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në veçanti në lidhje me kapacitetin dhe karakteristikat teknike të kërkuara.

Duke qenë se pajisja e ofruar nuk garanton përmbushjen e kriterëve të sakta të parashikuara, komisioni i vlerësimit ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me rregullat e prokurimit publik duke e eliminuar ofertën tuaj.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se eliminiimi i ofertës suaj është bërë në përputhje të plotë me dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi të prokurimit publik.

Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë, pasi mospërputhjet teknike të evidentuara përbëjnë arsye të ligjshme për skualifikim. Procesi i vlerësimit është kryer në mënyrë profesionale, objektive dhe të paanshme.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

Bazuar në të dhënat e lartëcekura Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe Legjislacionit sekondar të LPP-së.